



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 mars 2024
Nr.ref.:AGJ 2401/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI178/22

Parashtrues

Ibrahim Tërnav

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [REV. nr. 59/2021] të Gjykatës
Supreme të 6 majit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar,
Enver Peci, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ibrahim Tërnav, me vendbanim në Fushë Kosovë, i përfaqësuar nga Ndue Kurti, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 59/2021] e 6 majit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.1874/2016] e 12 qershorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.999/12] e 5 janarit 2016, si dhe Aktgjykimin Plotësues [C.nr.999/12] e 19 shkurtit 2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 25 korrik 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 59/2021] të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 18 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 2 dhjetor 2022, Gjykata e njoftoi (i) parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe (ii) njoftoi Gjykatën Supreme për kontestimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 59/2021] të 6 majit 2022 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
9. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR.KI178/22] caktoi Gjyqtarin Safet Hoxha - gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

10. Më 3 prill 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoj që ta njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 4 prill 2023, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregonte se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 25 korrik 2022.
12. Më 30 janar 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
13. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme; të konstatojë, njëzëri, që ka pasur shkelje të paragrafi 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës; ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.59/2021] të 6 majit 2022; konstatoi se ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Përmbledhja e fakteve

14. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Repartin e Trenave në Hekurudhat e Kosovës (në tekstin e mëtejme: HK), si makinist, që nga viti 1970 deri në fillimin e luftës në Kosovë. I njëjti, pas përfundimit të luftës ishte rikthyer në punë, në bazë të dokumentit të emërimit [nr.242] të 15 majit 2020, si punëtor me kontratë me afat të pacaktuar.
15. Më 28 shkurt 2001, përmes Vendimit [Nr. 163] të HK, parashtruesit të kërkesës iu ndërpre marrëdhëniet e punës për shkak të shkuarjes në pritje të pensionimit. Vendimi i lartpërmendur, kishte këtë përmbajtje: *“Në bazë të Instruksioneve Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2001/3 të datës 27.02.2001, të gjithë punëtorët e sistemuar-aktiv në HK ose të cilët gjenden në listën e punëtorëve rezervë të HK-së prej 350 sish e të cilët i kanë mbushur ose do t'i arrijnë gjatë vitit 2001, 60 vjet të moshës ose 35 vjet përvojë të punës duke llogaritur edhe përvojën e beneficuar sipas dispozitave ligjore mbi stazhin e beneficuar, do të marrin beneficionin për shërbim afatgjatë, duke filluar prej 01.03.2001, për punëtorët aktiv dhe rezervë të hekurudhës. Në bazë të evidencës në librin amë të punëtorëve, shihet se punëtori-ja Ibrahim Tërnava – Makinist, i ka gjithsej 37 vite përvojë pune dhe 49 vite moshë, nga i cili rezulton se janë plotësuar kushtet për vendosje si në dispozitiv të këtij Vendimi.”*
16. Më 6 mars 2001, parashtruesi i kërkesës bëri kërkesë për rishqyrtim të Vendimit [Nr. 165] të 28 shkurtit 2001, tek Organi Drejtues i HK. Lidhur me këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës nuk morri asnjë përgjigje.

Procedura e parë gjyqësore

17. Më 12 mars 2001, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës, për anulim të Vendimit të lartcekur dhe kërkoj nga e njëjta që: (i) t'ia aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, andaj Vendimin e lartcekur ta anulojë si të kundërligjshëm; dhe, (ii) Ta obligojë të paditurën (HK) që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës si makinist dhe t'i pranoj të gjitha të drejtat nga marrëdhëniet e punës duke filluar nga data 28 shkurt 2001 e deri në datën e kthimit në punë dhe ti mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës [...].

18. Më 12 shkurt 2003, Gjykata Komunale e Prishtinës (në tekstin në vijim: Gjykata Komunale) përmes Aktgjykimit [Cl.nr. 95/2001] vendosi: (i) Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës; (ii) anulohet si joligjor Vendimi për pensionimin e paditësit [Nr. 163] i 28 shkurtit 2001, i të paditurës – HK dhe detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në punë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke ia paguar edhe shpenzimet procedural [...].
19. Gjykata Komunale e Prishtinës arsyetoi: (i) E paditura – HK, vendimin kontestues gabimisht e ka mbështetur në Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2001/3, të 28 shkurtit 2001, neni 2, pika 2.2, gjë që është në kundërshtim me nenin 172 par. 1 pikën 3 të Ligjit për Punën e Bashkuar si dhe me Ligjin për Sigurimin Pensional e Invalidor të Kosovës; (ii) Nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pensionimin e parashtruesit të kërkesës edhe nëse i njëjti në momentin e dërgimit në pritje të pensionimit t'i ketë plotësuar 60 vite moshë apo 35 vite stazh pune; (iii) Pensionimi i parakohshëm mund të bëhet vetëm me dëshirën e punëtorit apo në raste të invaliditetit; (iv) HK nuk kanë qenë kompetent të vendosin për pensionimin e parashtruesit të kërkesës derisa nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore për pensionim; dhe, (v) Instruksionet Administrative nr. 2001/3 të zbatuara në rastin e paditësit nuk janë "Urdhëresë" administrative në kuptim të nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 – nuk e kanë as statusin e as fuqinë e Ligjit.
20. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit [Cl. Nr. 95/2001] të Gjykatës Komunale të Prishtinës të 12 shkurtit 2003, lidhur me lartësinë e shpenzimeve procedurale dhe gjithashtu edhe pala e paditur – HK, paraqiti ankesë ndaj të njëjtit për shkak të: (i) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe, (ii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 14 korrik 2003, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 188/2003] vendosi që të: (i) Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës së paditur – HK, kurse vërtetohet Aktgjykimi [Cl. nr. 95/2001] i Gjykatës Komunale, i 12 shkurtit 2003; dhe (ii) pjesërisht aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, ashtu që detyrohet HK që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën e përgjithshme prej 383 Euro. Gjykata e Qarkut në Prishtinë arsyetoi se konform nenit 365 të LPC-së, ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar ndërsa e të paditurës nuk është e bazuar.
22. Kundër Aktgjykimi të lartcekur, HK brenda afatit ligjor paraqiti kërkesë për revizion, kurse Prokurori i Shtetit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të dy aktgjykimet e cekura të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
23. Më 26 shkurt 2004, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 132/2003] vendosi që të: (i) Pranohen revizioni i të paditurës dhe kërkesa e Prokurorit të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë; dhe të: (ii) prishen Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut [Ac. nr. 188/2003] dhe Gjykatës Komunale [Cl. nr. 95/2001], kurse lënda i kthehet së njëjtës për rigjykim.
24. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) sipas neneve 386 dhe 408 të LPK-së, revizioni dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara; (ii) nuk është e qartë nga shkresat e lëndës së përse si palë e paditur janë cekur Hekurudhat e UNMIK-ut, palë kjo që është detyruar ta kthejë parashtruesin e kërkesës në punë, kurse në padi si palë e paditur është Hekurudhat e Kosovës dhe gjatë procedurës nuk është bërë ndryshimi i padisë; (iii) nuk ka të dhëna në shkresat e lëndës lidhur me statusin juridik të HK, përkatësisht

të UNMIK-ut nëse këto të dyja janë një ndërmarrje dhe nëse kjo është ose jo ndërmarrje publike, kush është themeluesi i saj dhe a është e regjistruar ajo tek organi kompetent për regjistrimin e përkohshëm të biznesit dhe a ushtron veprimtari ekonomike, nga e cila realizon të ardhura vetjake, a ushtron veprimtarinë me financim të UNMIK-ut dhe e kryen punën vetëm për nevojat e UNMIK-ut; (iv) lidhur me revizionin, duke u bazuar në nenin 385 par. 3 të LPK-së, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Procedura e dytë gjyqësore

25. Parashtruesi i kërkesës bën precizimin e padisë duke emëruar në cilësi të të paditurit Hekurudhat e UNMIKU-ut si trashëgimtare juridike e HK-së.
26. Më 9 qershor 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [Cl. nr. 118/2004]: (i) Refuzoi si të pabazë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me çka kishte kërkuar që të anulohet si joligjor Vendimi [Nr. 163] i 28 shkurtit 2001, i Hekurudhave të UNMIK-ut si dhe të detyrohet e paditura që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në punë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës; dhe (ii) Parashtruesi i kërkesës i bartë vet shpenzimet e veta procedurale.
27. Fillimisht Gjykata Komunale në Prishtinë sqaroi se në bazë të Memorandumit të UNMIK-ut për Mirëkuptim lidhur me Riintegrimin e Ndërmarrjes së Transportit Hekurudhor të Kosovë, të gushtit 1999, pika 2, është paraparë se *“udhëheqësia e përkohshme e Hekurudhës do të jetë nën direktivat dhe udhëheqjen e UNMIK-ut”*. Tutje e njëjta arsyetoi: (i) e paditura – Hekurudhat e UNMIK-ut në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së, është regjistruar si subjekt afarist, që nga 28 gushti 2002. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut [nr. 2000/47] të 18 gushtit 2000, për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij, nenit 3, *“UNMIK-u është i liruar nga çdo proces ligjor dhe se zyrtarët dhe personeli i tij lirohen nga juridiksioni vendor në lidhje me çfarëdo veprimi civil apo kriminal të kryer apo të ndërmarrë në territorin e Kosovës”*; (ii) me Kornizën Kushtetuese të Kosovës, kreu 8 (n) është e paraparë që Hekurudhat janë në kompetencë të PSSP të Kombeve të Bashkuara; (iii) rrjedhimisht, duke u bazuar edhe në nenin 77 të LPC-së, e paditura nuk mund të ketë cilësinë e palës në procedurë pasi që e njëjta në bazë të akteve të lartcekura, gëzon imunitet dhe nuk ka legjitimitet (pasiv) për të qenë palë e paditur.
28. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të: (i) zbatimi të gabuar të së drejtës materiale; dhe (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e tij të aprovohet, ose i njëjti aktgjykim të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.
29. Më 1 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 422/04] vendosi: *“Prishtë Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë [Cl. nr. 118/004] i 9 qershorit 2004, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.”*. Gjykata e Qarkut, arsyetoi si në vijim: (i) Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar faktin se e paditura nuk mund të jetë palë në procedurë për arsye se nga shkresat e lëndës nuk ka prova se parashtruesi i kërkesës pas lufte ka themeluar marrëdhënie pune; (ii) në bazë të parashtrësës [Nr.29] të së paditurës, të 17 majit 2004, është bërë reduktimi - largimi i 200 punëtorëve për faktin se e paditura gjendej para një krize ekonomike sepse nuk kishte zhvillim të transportit as për nevojat e UNMIK-ut, e as të KFOR-it; (iii) për marrjen e vendimit të ligjshëm për kthimin e parashtruesit të kërkesës në punë, Gjykata e shkallës së parë si çështje paraprake duhet të vërtetoj se a ka themeluar pas lufte

parashtruesi i kërkesës marrëdhënie pune tek e paditura, me çfarë akti, ose kontrate, dhe a ka qenë fare i sistemuar në vend të punës, apo jo.

30. Në fund Gjykata e Qarkut në Prishtinë theksoi se *“Për të vërtetuar këto fakte relevante lidhur me statusin e punës së parashtruesit të kërkesës tek e paditura pas lufte, është e detyruar të bëjë shikimin në aktin e përgjithshëm të të paditurës mbi sistematizimin e vendeve të punës pas lufte në Kosovë. Të bëhet shikimi në vendimin, apo kontratën mbi themelimin e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës me të paditurën. Ta ftoj parashtruesin e kërkesës të deklarohej për Njoftimin e 8 marsit 2001, se a është nënshkruar nga ana e tij, në të cilin theksohet se ‘Unë me këtë pranoj që kanë marr shumë e përgjithshme prej 1.200 DM për 10 muaj që është kompensim për shërbimin tim afatgjatë. Unë kam lexuar letrën shoqëruese të 1 shkurtit 2001, dhe e kuptoj dhe pranoj që kjo pagesë me mundëson dhe më obligon të lëshoj shërbimin në Hekurudhat e Kosovës tash e tutje’.”*

Procedura e tretë gjyqësore

31. Më 26 qershor 2008, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [Cl. nr. 399/2006] vendosi: (i) Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës; (ii) anulohet si joligjor Vendimi [Nr. 163] i HK, i 28 shkurtit 2001; dhe, (iii) Detyrohet e paditura që parashtruesit të kërkesës t’ia pranojë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga 28 shkurti 2001 e deri në kthimin e tij në punë përkatësisht deri më 1 tetor 2005 [...].
32. Në këtë aktgjykim, Gjykata Komunale qartëson se pas kthimit të parashtruesit të kërkesës në vendin e punës pas përfundimit të luftës, dokumenti i emërimit – Kontrata e punës së tij [Nr. 242] e 15 majit 2000, është e lidhur për kohë të pacaktuar pasi që nuk është paraparë kohëzgjatja e marrëdhënies së punës. Tutje, Gjykata thekson se nuk është kontestuese se parashtruesi i kërkesës ka nënshkruar vet personalisht Njoftimin e lartcekur të 8 marsit dhe se duke u bazuar në Vërtetimin [Nr. 52] të HK të 15 majit 2001, *“në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësi [...] ka pasur 49 vjet moshë, stazh pune 38 vjet, 10 muaj dhe 26 dite stazh efektiv pensioni dhe 9 vjet stazh i benificuar”*. Për më tepër, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e paditura më 1 tetor 2007 përsëri e kthen në punë parashtruesin e kërkesës, këtë herë me kontratë për kohë të caktuar [Nr. 5/453] të 1 tetorit 2007. Parashtruesi i kërkesës vazhdoi të punonte tek e paditura sipas Kontratës aktuale të punës [Nr. 5/111] të 30 prillit 2008, e cila vlente deri më datë 30 qershor 2008. Në vazhdim Gjykata Komunale në Prishtinë, arsyetoi se: (i) e paditura është regjistruar si subjekt afarist më 27 gusht 2002, më vonë se në kohën kur parashtruesit të kërkesës iu ndërpre marrëdhënien e punës; (ii) në bazë të nenit 77 të LPK-së, e paditura ka legjitimitet pasiv, rrjedhimisht mund të jetë palë në procedurë; (iii) Vendimi [Nr. 163] i 28 shkurtit 2001, është i paligjshëm sepse është në kundërshtim me nenin 115, par. 1 pika 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës së Kosovës, si dhe me nenin 172 par. 1, pika 3, e Ligjit të Punës së Bashkuar; (iv) Instrukcionet Administrative [Nr. 2001/3] të 27 shkurtit 2001, të nxjerra nga Departamenti i Transportit dhe Infrastrukturës nuk janë instrument plotësues konform një Rregulloreje të UNMIK-ut, nuk janë Urdhërese Administrative në kuptim të nenit 1.1 të Rregullores 1999/24, e nuk e kanë fuqinë e Ligjit; (v) HK nuk ka qenë kompetente të vendosë për pensionimin e punëtorit - parashtruesit të kërkesës përderisa ai nuk ka plotësuar asnjërin nga kushtet e domosdoshme për pensionim, as sa i përket moshës, as stazhit të pensionit, nuk kishte vullnet për këtë e as vendim të organit kompetent që rregullon çështjen e pensioneve.
33. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, pala e paditur paraqiti ankesë në afatin ligjor për shkak të: (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; si dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës

materiale, me propozimin që ankesa e parashtruesit të kërkesës të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi ankimor të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

34. Më 22 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1187/2008] refuzoi si të pa bazë ankesën e HK-së të ushtruar kundër Aktgjykimit [Cl. nr. 399/2006] të Gjykatës Komunale, të 26 qershorit 2006 dhe i njëjti vërtetohet. Në këtë kontekst, Gjykata e Qarkut arsyetoi që duke u bazuar në gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, vendimi i të njëjtës është i drejtë dhe se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike duke zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale; dhe se Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës [Nr. 2001/3] të UNMIK-ut, të 28 shkurtit 2001, nuk mund të shërbejnë si bazë ligjore për pensionimin e parakohshëm.
35. Në një datë të paspecifikuar, HK-ja në cilësi të të paditurës paraqiti kërkesë për revizion për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe, (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prisen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
36. Më 12 prill 2012, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 140/2009] vendosi si në vijim: (i) Pranohet revizioni i të paditurës; (ii) priset Aktgjykimi [Ac. nr. 1187/2008] i Gjykatës së Qarkut i 22 dhjetorit 2008 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) Vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë marrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 të LPK-së dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale; (ii) dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kontradiktor. Rrjedhimisht nuk mund të ekzekutohet pasi që edhe nuk janë cekur cilat të drejta do t'i pranojë e paditura parashtruesit të kërkesës nga marrëdhënia e punës nga 28 janari 2001 e deri në kthimin e tij në punë – 1 tetor 2005; (iii) Gjykata e shkallës së parë me anulimin e Vendimit [Nr. 163] të 28 shkurtit 2001, nuk e ka urdhëruar parashtruesin e kërkesës që ta precizojë kërkesëpadinë lidhur me të ardhurat personale, nëse është objekt i shqyrtimit për këtë periudhë kohore, sepse parashtruesi i kërkesës pas pranimi të vendimit të lartcekur e ka pranuar marrjen e shumës së përgjithshme prej 1.200 DM (gjithsej), për 10 muaj duke llogaritur nga 120 DM, në muaj; (iv) Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë llojin e kontratës lidhur me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës (me kohë të caktuar apo të pacaktuar) dhe se nuk e ka qartësuar se çfarë nënkuptohet me "[...] shkuarjes në pritje të pensionit", nëse me pritje nënkuptohet ndërprerja e marrëdhënies së punës apo pagesa e të ardhurave përderisa ekzistojnë kushtet për pension.

Procedura e katërt gjyqësore

37. Më 5 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C. nr. 999/12], vendosi që të: (i) aprovohet në tërësi kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës; (ii) anulohet si joligjor Vendimi [Nr. 163] i HK-së i 28 shkurtit 2001; (iii) detyrohet e paditura që parashtruesit të kërkesës t'ia njohë statusin e punëtorit makinist në kohë të pacaktuar si dhe t'i kompensojë në emër të ardhurave personale për periudhën *28 shkurt 2001 e deri me 1 tetor 2007*, shumën prej 16.646,37 Euro të ardhura personale, t'i paguaj shumën prej 1.819,83 Euro, në emër të kontributit pensional, për tatimin në burim shumën prej 642,02 Euro, me kamatë ligjore duke filluar nga data 12 mars 2001 e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 948,80 Euro e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

38. Gjykata Themelore në aktgjykimin e mësipërm ndër të tjera arsyetoi si në vijim: (i) Kjo gjykatë, ashtu si në procedurat e mëhershme, vlerëson se Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës [Nr. 2001/3] të 28 shkurtit 2001, nuk janë instrument plotësues nuk e kanë fuqinë e ligjit; (ii) në rastin konkret, ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi; (iii) e paditura nuk ka pasur kompetencë që të vendosë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, pa i plotësuar kushtet e domosdoshme për një veprim të tillë; (iv) Dokumenti i Emërimit - Kontrata [Nr. 242] e 15 majit 2000, është vërtetuar se është lidhur për kohë të pacaktuar; (v) në bazë të nenit 154 dhe 158 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gjykata Themelore vlerëson se parashtruesi i kërkesës është dëmtuar nga veprimet e kundërligjshme të të paditurës, andaj parashtruesit i takon kompensimi.
39. Më 19 shkurt 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit Plotësues [C. nr. 999/12], shtoi në pikën II të dispozitivit: “Detyrohet e paditura që paditësit [...] t’i paguaj shumën prej 1.819,83 Euro, në emër të kontributit pensional në lartësi prej 5% për periudhën 28.02.2001 e deri më 01.10.2007, [...]”. Tutje Gjykata Themelore në arsyetimin e saj thekson si në vijim: “[...] në nenin 277 të LMD-së nuk është paraparë kamata prej 3.5% ashtu që në pajtim me nenin 277 të LMD-së paditësit i aprovohet kamata në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që t’i paguaj kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim në afat mbi 1 vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.”.
40. Në një datë të paspecifikuar, HK-ja në cilësi të të paditurës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës; (ii) vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike; (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, Aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
41. Më 12 qershor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1874/2016], vendosi si në vijim: (i) Refuzohen si të pabazuara ankesat e të paditurës; (ii) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [C.nr.999/12] i 5 janarit 2016 dhe Aktgjykimi Plotësues [C.nr.992/12] i 19 shkurtit 2016, vërtetohen.
42. Në këtë aktgjykim, Gjykata e Apelit ndër të tjera arsyetoi si në vijim: (i) Duke u bazuar nga gjendja faktike e vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit konstatoi se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës Themelore është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nuk janë të përfshira në shkelje të dispozitave (neni 182, par. 2, pika b, g, j, k, dhe m) të LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë; (ii) Gjykata Themelore ka nxjerrë dhe administruar të gjitha provat e propozuara dhe të nevojshme, me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare si dhe të njëjtat i ka vërtetuar dhe arsyetuar në mënyrë specifike; (iii) Gjykata e shkallës së parë, vendimin në rastin konkret e ka nxjerrë në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës dhe Ligjit të Punës së Bashkuar – ligjet që kanë qenë në fuqi në kohën kur parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës; (iv) vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me Vendimi [Nr. 163] të 28 shkurtit 2001, është i pranuar edhe nga Gjykata e Apelit pasi që edhe kjo gjykatë konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat ligjore për shkuarje në pension; (v) lidhur me pretendimin për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ndaj Aktgjykimit Plotësues [C. nr. 999/12] të 19 shkurtit 2016, Gjykata e Apelit vlerësoi se janë të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë është bazuar në ekspertizën financiare të 31 gushtit 2015, për të vendosur lidhur me kompensimin e kontributit pensional të të ardhurave personale për periudhën

kontestuese; (vi) e paditura ka legjitimitet të plotë pasiv sepse është krijuar raporti detyrimor me të paditurën, rrjedhimisht e njëjta është pjesëmarrëse e marrëdhënies materialo-juridike nga e cila ka lindur kontesti pasi që Vendimi [Nr. 163] është marrë nga Drejtori i të paditurës që ka qenë i pajisur me kartelë identifikuese nga e paditura.

43. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, e paditura ushtroi revizion, për shkak të: (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) aplikimit të gabuar të së drejtës material. Parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar përgjigje në revizion me propozimin që i njëjti të refuzohet.
44. Më 6 maj 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 59/2021], vendosi: Aprovohet i bazuar revizioni i të paditurës, ashtu që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [AC.nr. 1874/16] i 12 qershorit 2020 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [C.nr. 999/12] i 5 janarit 2016, ndryshohen si vijon: *“REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar anulim të Vendimit të paditurës nr. 163 dt. 28.02.2001, me të cilin vendim të paditurës i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të daljes në pension, të detyrohet e paditura që paditësit t'i a njoh statusin e punëtorit makinist në kohë të pacaktuar si dhe t'i kompensoj të ardhurat personale për periudhën prej 28.02.2001 deri më 01.10.2007 në shumën prej 16.646,37 Euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 1.819,83 euro, në emër të tatimit në pagë, shumën prej 642,02 Euro me kamatën ligjore që do të llogaritet prej 12.03.2001 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 948,80 Euro, të gjitha këto në afatin prej shtatë ditëve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.”*
45. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë përmes aplikimit të gabuar të së drejtës materiale; (ii) pas vitit 1999 - periudha kur Kosova ka qenë nën protektoratin e UN, i gjithë aktiviteti i të paditurës – HK është vënë nën kompetencën e drejtpërdrejtë të KFOR-it dhe ashtu ka mbetur deri në momentin kur kalon nën menaxhimin e UNMIK-ut. Në pozitë të tillë, e paditura ishte deri në vitin 2005, kur është ndryshuar statusi i ndërmarrjeve në shoqëri aksionare, si dhe emri i ndërmarrjes e cila deri atëherë është quajtur Hekurudhat e UNMIK-ut. Andaj: *“nëse merret parasysh se e paditura është pasuese juridike e ndërmarrjeve në fjalë, e njëjta nuk mund të përgjigjet për situatat e krijuara me zbatimin e rregulloreve që ka nxjerrë ligjvënësi i vetëm i atëhershëm në Kosovë – UNMIK-u. Thjeshtë përmes rregulloreve të UNMIK-ut është rregulluar statusi i personave që kanë pasur një moshë të caktuar përkatësisht të stazhit të arritur”*; (iii) Gjykata Supreme thirret në faktin se pavarësisht që me 7 mars 2001, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga e paditura rishqyrtimin e vendimit nr. [163] të 28 shkurtit 2001, i njëjti me 8 mars 2001, ka nënshkruar pëlqimin që të pranojë kompensimin e caktuar, dhe është pajtuar me mundësinë që të detyrohet të lëshoj punën; (iv) Rrjedhimisht, e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për ndryshimet në statusin e të punësuarve që janë krijuar me aplikimin e akteve të përgjithshme – aplikimi i të cilave ka qenë i detyrueshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
47. Sipas parashtruesit të kërkesës: *“Gjykata Supreme me pranimin e revizionit dhe ndryshimin e vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta, dhe me refuzimin si të*

pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit, ka vepruar kundër praktikës së saj gjyqësore, sepse për rrethana të njëjta – plotësisht të njëjta tek rasti im ka vendosur krejt ndryshe, dhe me këtë ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, sepse më ka vënë në pozitë të pabarabartë me qytetarët tjerë për kërkesat plotësisht identike". Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës, referohet në katër raste të vendosura nga Gjykata Supreme, përkatësisht: (i) rasti Ismet Gashi (I.G) vendosur përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 92/2005] të 14 qershorit 2005; (ii) rasti Muharrem Jashanica (M.J) vendosur përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 33/2005] të 14 qershorit 2005; (iii) rasti Rrahim Imeri (Rr. I) vendosur përmes Aktgjykimit [Rev-Mlc nr. 233/2011] të 8 majit 2013; si dhe (iv) rasti Ahmet Krasniqi (A.K) vendosur përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 215/2021] të 29 korrikut 2021.

48. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i përmbushë kriteret për një *aktgjykim të arsyetuar* dhe të arsyeshëm si dhe detyrimet e të njëjtit sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm, lidhur me refuzimin e kërkesës së parashtruesit si të pabazuar.
49. Parashtruesi i kërkesës thekson se: *"gjykata nuk jep arsytet se cilat ligje janë aplikuar gabimisht nga ana e gjykatave të shkallëve të ulëta, nuk jep sqarimet për aktin administrativ i cili rregullon ndryshe marrëdhëniet e punës nga ligji në fuqi, nuk jep arsytet mbi cilën bazë pasuesi i një subjekti juridik përjashtohet nga përgjegjësia e paraardhësit dhe administron një Udhëzim Administrativ të paqenë"*. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
50. Në pjesën e arsyetimit ku Gjykata Supreme përshkruan historikun e pozitës së të paditurës, në kohën kur Kosova ishte nën drejtimin e UNMIK-ut, parashtruesi i kërkesës e cilëson këtë arsyetim si të përgjithshëm dhe si arsyetim i cili nuk plotëson kriteret ligjore sipas neneve 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, praktikës gjyqësore të Kosovës dhe asaj të GJEDNJ-së.
51. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se arsyetimi në fjalë *"nuk i gjason një aktgjykimi të shkallës më të lartë të gjyqësorit, të Gjykatës Supreme por një ligjërimit politik. Me asnjë fjalë nuk përmendet cila është dispozita ligjore që është aplikuar gabimisht nga instancat e ulëta"*.
52. Lidhur me arsyetimin e Gjykatës për Instruksionin Administrativ të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës 2001/3 të 27 shkurtit 2001, parashtruesi i kërkesës thotë se: *"Gjykata nuk jep sqarime në arsyetim të aktgjykimit lidhur me këtë"*.
53. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se ndër të tjera, ka konstatime jo të sakta si: *"Si ndërmarrje e rëndësishme të jashtëzakonshme si ekonomike ashtu edhe e rëndësishme strategjike i gjithë aktiviteti i hekurudhës transporti i udhëtarëve dhe mallit dhe komunikacioni hekurudhor në përgjithësi janë vënë nën kompetencën e drejtpërdrejt të misionit ushtarak të KFOR-it dhe në atë status kanë mbetur deri në vitin 2022 është menduar deri në vitin 2002"*. Ai sqaron se: *"Hekurudhat kanë pasur Kontratë specifike me KFOR-in për transportin e derivateve, mjeteve dhe personelit të tyre por nuk ka qenë nën kompetenca të KFOR-it"*.
54. Sipas parashtruesit të kërkesës, përveç se ka konstatim të gabuar, aktgjykimi i goditur është edhe kontradiktor në vetvete sepse *"kur e paditura është pasuese juridike e ndërmarrjes në fjalë nuk mund të ikë nga përgjegjësia e detyrimeve të krijuara nga paraardhësi, kjo është normë elementare, dhe se UNMIK-u nuk ka sjellë rregullore që"*

rregullojnë statusin e personave që kanë pasur një moshë të caktuar përkatësisht të stazhit të arritur. Gjykata gabimisht e barazon Instruksionin Administrativ të nxjerrë nga Departamenti i Transportit dhe Infrastrukturës me Rregulloret e UNMIK-ut të nxjerrra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB për Kosovë”.

55. Lidhur me Udhëzimin Administrativ [Nr. 2000/4] i 26 majit 2000 të cilin e ka dhënë Përfaqësuesi Special (sipas Gjykatës Supreme), parashtruesi i kërkesës e cilëson këtë si spekuluese pasi që sipas tij: “Nuk ekziston Udhëzim Administrativ me numër 2000/4 që i referohet Hekurudhave të Kosovës. Ishte një draft i këtij udhëzimi por kurrë, nuk u nënshkrua as u aprovua që parashtruesi e kishte bërë me dije gjykatën. Udhëzimi Administrativ nr. 2000/4 i dt. 02.03.2000 ka të bëjë me implementimin e Rregullores 2000/8 të dt. 28.02.2000 për regjistrimin e përkohshëm të bizneseve në Kosovë”.
56. Për fund, parashtruesi i kërkesës thotë: “Konsiderojmë se ky aktgjykim në rastin tim është arbitrar dhe presim që Gjykata Kushtetuese këto shkelje dhe arbitraritete t'i evitojë, sepse me këto lloj vendimesh shkelet edhe parimi i sigurisë juridike, e që sipas Kushtetutës e ligjeve për gjykatat, ajo Gjykata Supreme duhet të bëjë unifikimin e praktikës gjyqësore të gjykatave tjera, e ajo nuk ka unifikim në marrje të vendimeve as brenda kolegjeve të saj”.
57. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që I. ta deklarojë kërkesën të pranueshme; II. të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 59/2021] i 6 majit 2022, nuk është në pajtim me paragrafin 1 të nenin 24, paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; III. të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 59/2021] të 6 majit 2022; IV. të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; v. të urdhërojë Gjykatën Supreme që në pajtim me rregullin 66 të Rregullores së punës, ta njoftojë gjykatën për masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të aktgjykimit të kësaj gjykate.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NENI 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

RREGULLORE NR.2000/47

UNMIK/REG/2000/47

18 Gusht 2000

**PËR STATUSIN, PRIVILEGJET DHE IMUNITETIN E KFOR-IT,
UNMIK-UT DHE TË PERSONELIT TË TYRE**

Neni 3
STATUSI I UNMIK-UT DHE I PERSONELIT TË TIJ

3.1 UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruar nga çfarëdo procesi ligjor.

[...]

Departamenti i Transportit dhe i Infrastrukturës
Instrukcionet Administrative Nr. 2001/3 në të Drejtën për
shërbim afatgjatë dhe pakon e kompensimit për punëtorët e Hekurudhës
që largohen nga puna

Bashkëkryesuesit e Departamentit të transportit dhe infrastrukturës, në përputhshmëri me autoritetin që u është dhënë në paragrafin 2.5 (b) të Rregullores Nr. 2000/25, mbi formimin e Departamentit administrativ të transportit dhe infrastrukturës,

Lëshojnë këtë Instrukcion Administrativ:

[...]

Paragrafi 2
E drejta për shërbim afatgjatë

2.1 Punëtori aktual i Hekurudhës i cili gjatë vitit 2001 arrin moshën 60 vjeçare ose akumulon së paku 35 vjet të punësimit “përfitues” në Hekurudhë, e cila do të arrihet më shpejtë, duhet të lëshojë punën në hekurudhë. Ky punëtor ka të drejtë të pranojë Benificionin për shërbimin afatgjatë siç është cekur në Instrukcionin Administrativ. Gjatë llogaritjes së viteve të përgjithshme të “punësimit përfitues” të punëtorit, do të lejohet një shumë e caktuar për punën e rrezikshme në përputhje me ligjet e mëparshme të Hekurudhës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

60. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”
[...]*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

61. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.59/2021] e 6 majit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
62. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës gjithashtu plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafi 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
63. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj. (Shih gjithashtu, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat

64. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme shkelet e drejta e tij për një *vendim të arsyetuar*, gjë që në vetvete çon edhe në shkeljen e së drejtës për siguri juridike. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këto shkelje kanë ndodhur pasi që Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat lidhur me *ndryshimin e qëndrimit* përkitazi me mos aprovimin e kërkesëpadisë së tij, krahasuar me qëndrimin të cilin e kishte zbatuar në mënyrë konsistente në 4 raste tjera.
65. Nga shkresat e lëndës, dhe nga mënyra e arsyetimit të pretendimeve në kërkesë, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me: (I) *mos arsyetimin e vendimit gjyqësor*, për sa i përket: (i) mungesës së arsyetimit nga Gjykata

Supreme se cilat ligje ishin aplikuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë; si dhe (ii) mungesa e dhënies së arsytimit lidhur me çështjen që Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës konsistojnë në akt nënligjor. Pretendimet për mungesë të vendimit të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh edhe me moskonsistencë të praktikës gjyqësore si rezultat i vendosjes ndryshe të katër rasteve me rrethana të njëjta faktike dhe juridike nga ana e Gjykatës Supreme. Parashtruesi më tej pretendon se në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme mungon arsyetimi përkatës për qasjen të cilën ajo e mori në rastin e tij. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në të vërtetë ngre çështje të mos arsytimit të vendimit të Gjykatës Supreme në lidhje me mos konsistencën e praktikës gjyqësore nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së.

66. Në vazhdim, Gjykata do t'i analizojë këto pretendime të parashtruesit të kërkesës në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

I. Pretendimet për shkelje të së drejtës për “vendim të arsyetuar”

a) Parimet e përgjithshme

67. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 120).
68. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GjEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).

69. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GjEDNj-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 134/1996/753/952. Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin e GjEDNj-së [Morerira Ferreira kundër Portugalisë](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përmendura aty; shih edhe rastet e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
70. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës nr. [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; [KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; [KI87/18](#), parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138; dhe së fundmi rastin [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 123).

II. Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

71. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me mungesën e arsyetimit të vendimit të kontestuar, përkritazi me mos aprovimin e kërkesëpadisë së tij për sa i përket anulimit të vendimit të të paditurës nr. [163] me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkuarjes në pension, dhe dhënia e kompensimit respektiv për periudhën 28 shkurt 2001 – 1 tetor 2007. Në kuadër të këtij pretendimi parashtruesi vë theksin tek (i) mungesa e arsyetimit nga Gjykata Supreme se cilat ligje ishin aplikuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë të cilat kishin aprovuar kërkesëpadinë e tij; si dhe (ii) mungesa e dhënies së arsyetimit lidhur me çështjen që Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës konsistojnë në akt nënligjor. Pretendimet për mungesë të vendimit të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh edhe me moskonsistencë të praktikës gjyqësore si rezultat i vendosjes ndryshe të katër rasteve me rrethana të njëjta faktike dhe juridike nga ana e Gjykatës Supreme.

72. Në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [Rev. nr. 59/2021] të 6 majit 2022, të Gjykatës Supreme, e cila arsyetoi si në vijim:

“Në periudhën pas vitit 1999, e paditura ka rënë nën menaxhim të UNMIK-ut. Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm përmes Udhëzimit Administrativ numër 2000/4, i cili ka hyrë në fuqi me datën 26.05.2000, ka rregulluar mënyrën e funksionimit të paditurës, dhe ka shfuqizuar të gjitha rregulloret që kanë qenë në kundërshtim me udhëzimin administrativ numër 2000/1 dhe 1999/1 të nxjerra nga UNMIK-u. Përmes rregullores së UNMIK-ut numër 2000/25 është formuar Departamenti Administrativ për transport dhe infrastrukturë. Departamenti administrativ për transport dhe infrastrukturë ka lëshuar udhëzimin administrativ numër 2001/3 në muajin shkurt të vitit 2001, në të cilin në nenin 2 ka paraparë që punëtorët e hekurudhës që mbushin 60 vjet apo së paku 35 vjet stazh të punës, duhet të lëshojnë punën në hekurudhë. Për këta punëtorë janë paraparë kompensimet e caktuara që duhet të paguhen deri në fund të vitit 2001. Udhëzimi në fjalë parasheh që në rast se nxjerret program adekuat social, pagesa e kompensimit për këtë kategori do të vazhdoj deri 31.12.2003. Me këtë udhëzim të njëjte është parapare kategoria e punëtorëve aktiv dhe punëtorëve rezerve. Pasi që paditësi ka rënë në kategorinë e personave në programin e cekur, ai është përfshirë në këtë program. Me vendimin e të paditurës numër 163 dt. 28.02.2001, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe i janë siguruar të gjitha benefitet e përcaktuara me aktet e paraqitura sipër.”

73. Megjithatë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i adreson pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk jep arsyetim adekuat se *“cilat ligje ishin aplikuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë”*, të cilat e kishin aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, si dhe nuk kishte dhënë arsyetim lidhur me çështjen që Instruksionet Administrative të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës 2001/3 konsistonin në akt nënligjor, e jo në rregullore të UNMIK-ut, të cilat e kishin statusin e barabartë me ligje.
74. Lidhur me këtë, Gjykata nuk i konsideron kontestuese qëndrimet e Gjykatës Supreme lidhur me interpretimin e saj se cili ligj do të zbatohet në rastin konkret, sepse kjo është në juridiksionin e asaj gjykate. Megjithatë, ajo që Gjykata Supreme nuk ka arritur të shpjegoj është pikërisht raporti midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra-tjetrën dhe se si kanë ndikuar ato në vendimin e Gjykatës Supreme që t'i ndryshojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës.
75. Pra, e drejta për një vendim të arsyetuar përtej faktit që pretendimi duhet të jetë pretendim thelbësor, përcaktues dhe vendimtar për fitimin apo mosfitimin e të drejtës së pretenduar, i njëjti duhet të shpërfaqë gjithashtu që parashtruesi është dëgjuar dhe ka marrë mjaftueshëm sqarime se pse nuk e gëzon të drejtën e pretenduar. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se vendimi i Gjykatës Supreme paraqet shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
76. Në këtë aspekt, Gjykata përsërit se GJEDNJ, ndër të tjera, në Aktgjykimin *Hiro Balani*, cituar me lart, dhe specifikisht në rastin *Donadze kundër Gjeorgjisë* (kërkesa nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 marsit 2006, paragrafi 35) mori qëndrimin se gjykatat vendore nuk kishin kryer një shqyrtim të plotë dhe serioz të pretendimeve vendimtare dhe përcaktuese të parashtruesit të kërkesës. Thënë këtë, edhe nëse gjykatave nuk mund t'u

kërkohet të deklarojnë bazat për refuzimin e çdo argumenti të një pale, megjithatë ato nuk përjashtohen nga shqyrtimi dhe dhënia e arsytimit të duhur ndaj pretendimeve kryesore dhe vendimtare të ngritura prej parashtruesit të kërkesës.

77. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës se përse mohohen të drejtat e tij të pretenduara për pagesën e pagave të pa paguara nga marrëdhënia e tij e punës. Rrjedhimisht, vendimi i kontestuar nuk i ka plotësuar kriteret e drejtësisë siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, paragrafi 115).
78. Në vijim, Gjykata sqaron që pretendimet për mungesë të vendimit të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh edhe me moskonsistencë të praktikës gjyqësore si rezultat i vendosjes ndryshe të katër rasteve me rrethana të njëjta faktike dhe juridike nga ana e Gjykatës Supreme.
79. Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme, në rastet e mëparshme, të njëjta, me pothuajse të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, ka nxjerr aktgjykime krejtësisht të ndryshme, të cilat i njëjti i dorëzoi në Gjykatë si shembuj në kërkesën e tij. Parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve specifike të Gjykatës Supreme, të cilat ai përmes kërkesës i paraqiti në Gjykatë si shembuj:

“[Rev. nr. 92/2005] të 14 qershorit 2005; [Rev. nr. 33/2005] të 14 qershorit 2005; [Rev-Mlc nr. 233/2011] të 8 majit 2013; [Rev. nr. 215/2021] të 29 korrikut 2021”.

80. Lidhur me këtë, kjo Gjykatë duhet të shqyrtojë nëse si rezultat i vendimit të paarsyetuar gjyqësor ka pasur shkelje të parimit të sigurisë juridike si një segment i së drejtës për një gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata do të përpiket që përmes analizës krahasuese të aktgjykimeve të dorëzuara të Gjykatës Supreme të përcaktojë: *nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit; nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie; dhe nëse ky mekanizëm është zbatuar, dhe nëse po, në çfarë mase.*
81. Në fillim, Gjykata thekson se ajo ka analizuar të gjitha Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të cilat janë dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë. Gjykata vërejtë faktin se në të gjitha rastet e përmendura, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësve nga e paditura, të njëjtit kishin më shumë se 35 vite përvojë pune (duke përfshirë edhe stazhin e beneficuar) tek e paditura – HK, dhe nuk kishin arritur ende moshën prej 65 viteve.
82. Në bazë të Aktgjykimeve të dorëzuara, paditësit ishin larguar nga puna (i) në të njëjtën datë (28 shkurt 2001), dhe (ii) mbi bazën e njëjtë ligjore, përkatësisht Instruksionin Administrativ të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës, Nr. 2001/3 të 27 shkurtit 2001, sikurse parashtruesi i kërkesës. Gjykata gjithashtu vërejtë se në të gjitha Aktgjykimet e lartcekura, Gjykata Supreme vendosi në favor të palëve paditëse, me arsytimin se Instruksioni Administrativ 2001/3, nuk mund të jetë bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Analiza krahasuese e Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 92/2005, i 14 qershorit 2005

83. Nga Aktgjykimi i lartcekur, Gjykata vëren se paditësit – I.G, i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkuarjes në pritje të pensionit, në bazë të Instruksionit Administrativ Nr. 2001/3. Tutje, të njëjtit në bazë të Instruksionit Administrativ, i sigurohet beneficioni për shërbim afatgjatë në shumën prej 120 DM në muaj për tërë vitin. Paditësi deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, arriti 36 vite përvojë punë dhe 58 vite moshë.
84. Fillimisht, Gjykata Supreme paraqet qëndrimet e Gjykatave të instancës më të ulët, përkatësisht: (i) vendimi i të paditurës [Nr. 165] me të cilin i është ndërprerë paditësit marrëdhënia e punës, nuk mund të jetë bazë ligjore për ndërmarrjen e një veprimi të tillë; (ii) në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për marrjen e këtij vendimi; (iii) bazuar në faktin se ka ekzistuar marrëdhënia e punës së paditësit me të paditurën, në kohë të pacaktuar, dhe të njëjtit iu ka pamundësuar të punojë në vendin e tij të punës bazuar në Instruksionin Administrativ 2001/3 – dokument ky që nuk mund të jetë bazë ligjore për ndërprerje të marrëdhënies së punës, rrjedhimisht Gjykatat e instancës më të ulët e detyruan të paditurën që paditësin ta kthejë në vendin e punës.
85. Gjykata Supreme e arsyetoi qëndrimin e saj në këtë mënyrë:

“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se aktgjykimet e tyre nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare”.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 92/2005, i 14 qershorit 2005

86. Paditësit – M.J, i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkuarjes në pritje të pensionit, më 28 shkurt 2001, në bazë të Instruksionit Administrativ të lartcekur. Paditësi deri më 28 shkurt 2001, kishte arritur 61 vite moshë dhe 40 vite përvojë pune.
87. Nga Aktgjykimi [Rev. nr. 92/2005] i 14 qershorit 2005, Gjykata vëren Gjykatat e instancës më të ulët konkluduan se Vendimi me të cilin ishte larguar paditësi nga puna, nuk mund të jetë bazë ligjore për këtë veprim pasi që paditësi nuk kishte plotësuar kriteret që dalin nga Instruksioni Administrativ 2001/3. Rrjedhimisht, e detyruan të paditurën që paditësin ta kthejë në punë. Më tej Gjykata vëren se Gjykata Supreme përdori të njëjtën praktikë edhe në rastin konkret, ku konkludoi:

“Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se aktgjykimet e tyre nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare”.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Mlc. nr. 233/2011, i 5 majit 2013

88. Gjykata vëren se Gjykata Supreme edhe në Aktgjykimin [Rev. Mlc. nr 233/2011] e 5 majit 2013, refuzoi revizionin e të paditurës dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit. Sipas gjendjes faktike të elaboruar në këtë Aktgjykim, rezulton se paditësit – RR.I, i është ndërprerë marrëdhënia e punës për të njëjtat arsye dhe mbi të njëjtën bazë ligjore, ashtu si në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe në rastet e lartcekura.

89. Gjykata Supreme konstaton se pajtohet me konkludimin e gjykatave të instancave më të ulëta, ku ndër të tjera, ceket se edhe në këtë rast Instruksioni Administrativ 2001/3 nuk është bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
90. Gjykata tutje gjeti se Gjykata Supreme kundërshton pretendimet se e paditura nuk ka legjitimitet pasiv. Qëndrimin e saj, Gjykata Supreme e arsyetoi në këtë mënyrë:

“[...] Pa marrë parasysh se e paditura ka bërë ndryshime në emrin e saj, në rastin konkret padia është drejtuar ndaj punëdhënësit, në të cilin, sipas bazës së marrëdhënies së punës paditësi në cilësinë e punëtorit i ushtron të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës.

Faktin e cekur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se në bazë të Rregullores 2000/47 datë 18.08.2000, për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut deh personelit të tyre, Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se paditësi i ka realizuar të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës te e paditura dhe me vendimin e të paditurës, paditësi është suspenduar nga puna, prandaj është e papranueshme thënia se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv në këtë kontest. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, vendimi mbi pushimin e marrëdhënies së punës të të punësuarit mund të merret në mënyrë dhe në kushtet e parapara me ligj.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 215/2021, i 29 korrikut 2021

91. Gjykata vëren nga Aktgjykimi [Rev. nr. 215/2021], i 29 korrikut 2021, i Gjykatës Supreme, se sikurse në rastin e parashtresës të kërkesës dhe në ato të elaboruara deri më tani, paditësit - A.K i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkuarjes në pritje të pensionit. Çështja që kontestohet në këtë Aktgjykim është kompensimi i dëmit për shkak të mos pagesës së të ardhurave personale për periudhën 28 shkurt 2001 deri më 30 maj 2006, përkatësisht periudha kur paditësi nuk ishte në punë, si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga e paditura.
92. Gjykata Supreme përkitazi me çështjen e kompensimit të dëmit konkludoi:

“Në rastin konkret, përgjegjësia e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me pushimin e paligjshëm të marrëdhënies së punës, sipas natyrës së saj juridike, paraqet përgjegjësi subjektive, d.m.th përgjegjësi sipas fajësisë së punëdhënësit (të paditurës). [...] Sipas dispozitës së nenit 189.3 të LMD-së është paraparë se me rastin e vlerësimit të fitimit të humbur, merret parasysh fitimi i cili me bazë ka mundur të pritët sipas rrjedhës së rregullt të çështjes pse rrethanave të veçanta, realizimi i të cilit është penguar me veprimin e lëshimit të dëmtuesit. Në përputhje me këtë dispozitë, i punësuar, këtu paditësi, ka të drejtën e shpërblimit të dëmit, në lartësi të fitimit të humbur, të cilin do ta kishte realizuar në kohën në të cilën me vendimin për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënies së punës iu ka bërë e pamundur të punojë”.

93. Gjykata në bazë në bazë të analizës së aktgjykimeve të përmendura të Gjykatës Supreme, gjen se ekzistojnë dallime të dukshme në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, të cilat kanë vendosur për revizionin e të paditurës. Në aktgjykimet e kontestuara nga parashtresë i kërkesës, vërehet ngjashmëri, pothuajse në të gjitha rrethanat faktike, me rastin e parashtresës. Gjithashtu, Gjykata nuk mund të mos vërejë se në të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Supreme ekziston mospërputhje në praktikën gjyqësore shumëvjeçare.

94. Në vijim, Gjykata i referohet edhe Ligjit për Gjykatat, nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin në juridiksionin e të cilit gjendet edhe çështja e përshtatjes dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14

Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

[...]

2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika;...”.

95. Nga kjo rezulton se mekanizmi i harmonizimit të praktikës gjyqësore është parashikuar me vetë dispozitën ligjore. Për më tepër, funksionimi i vetë mekanizmit të harmonizimit të praktikës nuk është i pamundësuar, apo i kufizuar me asgjë, gjë që do të zvogëlonte drejtpërdrejt zbatimin dhe efikasitetin e tij në vetë praktikën.

Përfundim

96. Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, konkludon se Gjykata Supreme në aktgjykimet krahasuese, të cilat korrespondojnë plotësisht me gjendjen faktike dhe juridike të aktgjykimit në fjalë, kishte nxjerrë aktgjykime me arsyetime juridike të cilat dallojnë nga aktgjykimi i kontestuar.
97. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos e theksojë në veçanti se Gjykata Supreme në aktgjykimet krahasuese vazhdimisht theksoi se Instruksioni Administrativ 2001/3, nuk mund të jetë bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorëve. Në bazë të Aktgjykimit [Rev. nr. 59/2021], Gjykata Supreme morri një qëndrim tjetër krahasuar me qëndrimet e mëparshme – përkatësisht ato të prezantuara nga parashtruesi i kërkesës.
98. Gjykata ka parasysh se gjykatat e rregullta, gjatë ndërtimit të praktikës gjyqësore, mund të marrin vendime të ndryshme, gjë që pasqyron zhvillimin e praktikës gjyqësore. Megjithatë, shmangiet nga konsistenca e praktikës gjyqësore duhet të kenë justifikime dhe shpjegime objektive dhe të arsyeshme, të cilat, në rastin konkret në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme mungojnë.
99. Në veçanti, Gjykata thekson faktin se në rastin konkret vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është vendim përfundimtar, kundër të cilit nuk ka mjete të tjera efektive juridike në dispozicion sipas ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, si gjykata më e lartë në hierarkinë gjyqësore, kishte një përgjegjësi të veçantë për të arsyetuar vendimin me të cilin do t'i shpjegonte të gjitha arsyet e shmangies nga praktika e deritanishme gjyqësore.
100. Si përfundim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme si gjykatë e instancës së fundit për të vendosur në rastin konkret të parashtruesit, duke marrë një qëndrim të ndryshëm në Aktgjykimin e kontestuar në një rast i cili është plotësisht identik ose i ngjashëm me rastet e tjera, pa dhënë një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për këtë, ka shkelur të drejtën e parashtruesit për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të ndërlidhur me shkelje të parimit të sigurisë juridike, si një nga komponentët themelore të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.

101. Përfundimisht, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 janar 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, [Rev. nr. 59/2021], të 6 majit 2022;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 59/2021], të 6 majit 2022, për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së Punës, deri më 30 korrik 2024, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportuese

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka - Nimani